



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arhivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive	
Nr./Br./No.	3311
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	4
Data/Datum/Date:	10.08.2023
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrisë / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-277/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Fundamentum 700 WG** i prodhuesit “**Innvigo Sp. z o.o.**”, **Poloni** nga përfaqësuesi i saj “**Monuni**”, **SH.P.K, Gjilan**.

2. **LLOJI I PRODUKTIT:** Herbicid

3. **PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Tribenuron-methyl.....400g/kg
Metsulfuron-methyl.....135g/kg
Florasulam.....165g/kg

4. PËRDORIMI:

Fundamentum 700 WG është i destinuar për përdorim me një spërkatëse vetëlëvizëse ose me traktor me spërkatëse lavërtarie.

Grurë dimëror, tritikale dimërore, thekër dimëror, koha e trajtimit: aplikoni produktin në fazat nga vëllazërimi-kërçelli i parë i dallueshëm e deri te gjethja e flamurthit e pa shpalosur (BBCH 21–39). a) Përdorimi individual

Doza maksimale/e rekomanduar për një aplikim: 30 g/ha. Numri i trajtimeve: 1.

a) Përdorimi si i kombinuar me lagështues, doza maksimale/e rekomanduar për një aplikim: Fundamentum 700 WG 25 g/ha + Asystent + 0.1 l/ha. Numri i trajtimeve: 1. Sasia e rekomanduar e ujit: 200–300 l/ha. Spërkatja e rekomanduar: pikëza-mesatare. Numri maksimal i trajtimeve gjatë vegetacionit: 1.

Gruri pranveror, elbi pranveror

Koha e trajtimit: aplikoni produktin në fazat nga vëllazërimi-kërçellit të parë të dallueshëm e deri në nyjën e dytë (BBCH 21–32).

a) Përdorimi individual

Doza maksimale/e rekomanduar për një aplikim: 30 g/ha.

Numri i trajtimeve: 1

b) Përdorimi si i kombinuar me lagështues

Doza maksimale/e rekomanduar për një aplikim:

Fundamentum 700 WG 25 g/ha + Asystent + 0.1 l/ha

Numri i trajtimeve: 1.

Sasia e rekomanduar e ujit: 200–300 l/ha.

Spërkatja e rekomanduar: pikëza-mesatare.

Grurë dimëror, tritikale dimërore, thekër dimëror:

	Përdorimi i pa kombinuar:	Përdorimi i përzier me lagështues:
Barërat e këqija të ndjeshme:	<i>Lithospermum arvense</i> (kokërrujen e arave), <i>Lamium amplexicaule</i> (hithëbuten kërçellpështjellëse), <i>Fumaria officinalis</i> (fumaren mjekësore), <i>Cirsium arvense</i> (cirzën e arave), <i>Matricaria chamomilla</i> (kamomilin), <i>Thlaspi arvense</i> (tlaspin e arave), <i>Papaver rhoeas</i> (lulëkuqen), <i>Centaurea cyanus</i> (kokëçelin), <i>Stellaria media</i> (stellaren e ndërmjetme), <i>Lamium purpureum</i> (hithërbutën e purpurt) <i>Capsella bursa-pastoris</i> (shtraperën), <i>Brasica napus</i> (kolzen e vetëmbirë), <i>Galium aparine</i> (ngjitësi), <i>Tripleurospermum inodorum</i> (kamomilin e rrem), <i>Myosotis arvensis</i> (lulemizën e arave), <i>Galeopsis tetrahit</i> (galeopsin katërhojesh).	<i>Lithospermum arvense</i> (kokërrujen e arave), <i>Lamium amplexicaule</i> (hithërbutën kërçellpështjellëse), <i>Fumaria officinalis</i> (fumaren mjekësore), <i>Cirsium arvense</i> (cirzën e arave), <i>Matricaria chamomilla</i> (kamomilin), <i>Thlaspi arvense</i> (tlaspin e arave), <i>Papaver rhoeas</i> (lulëkuqen), <i>Centaurea cyanus</i> (kokëçelin), <i>Stellaria media</i> (stellaren e ndërmjetme), <i>Lamium purpureum</i> (hithërbutën e purpurt) <i>Capsella bursa-pastoris</i> (shtraperën), <i>Brasica napus</i> (kolzen e vetëmbirë), <i>Galium aparine</i> (ngjitësi), <i>Tripleurospermum inodorum</i> (kamomilin e rrem), <i>Myosotis arvensis</i> (lulemizën e arave), <i>Galeopsis tetrahit</i> (galeopsin katërhojesh).
Barërat e këqija mesatarisht të ndjeshme:	<i>Polygonum aviculare</i> (bar patën), <i>Veronica arvensis</i> (veronikën e arave), <i>Viola arvensis</i> (manushaqen e fushave), <i>Veronica persica</i> (veronikën persiane), <i>Apera spica-venti</i> (aperen kalliere), <i>Geranium pusillum</i> (kamoroshen e vogël).	<i>Polygonum aviculare</i> (bar paten), <i>Veronica arvensis</i> (veronikën persiane), <i>Viola arvensis</i> (manushaqen e fushave), <i>Veronica persica</i> (veronikën persiane), <i>Apera spica-venti</i> (aperen kalliere), <i>Geranium pusillum</i> (kamoroshen e vogël).

Gruri pranveror, elbi pranveror:

	individual use	use in a mixture with an adjuvant
Barërat e këqija të ndjeshme:	<i>Chenopodium album</i> (këmbëpatën/laboti butë), <i>Lamium amplexicaule</i> (hithërbutën kërcellpështjellëse), <i>Cirsium arvense</i> (cirzën e arave), <i>Myosotis arvensis</i> (lulemizen e arave), <i>Matricaria chamomilla</i> (kamomilin), <i>Papaver rhoeas</i> (lulëkuqen), <i>Stellaria media</i> (stellaren e ndërmjetme), <i>Lamium purpureum</i> (hithërbutën e purpurt) <i>Capsella bursa-pastoris</i> (shtraperën), <i>Brasica napus</i> (kolzen e vetëmbirë), <i>Galeopsis tetrahit</i> (galeopsin katërhojesh), <i>Tripleurospermum inodorum</i> (kamomilin e rrem), <i>Galium aparine</i> (ngjitësi), <i>Fallopia convolvulus</i> (fallopin dredhëz).	<i>Chenopodium album</i> (këmbëpatën/laboti butë), <i>Lamium amplexicaule</i> (hithërbutën kërcellpështjellëse), <i>Cirsium arvense</i> (cirzën e arave), <i>Myosotis arvensis</i> (lulemizën e arave), <i>Matricaria chamomilla</i> (kamomilin), <i>Papaver rhoeas</i> (lulëkuqen), <i>Stellaria media</i> (stellaren e ndërmjetme), <i>Lamium purpureum</i> (hithërbutën e purpurt) <i>Capsella bursa-pastoris</i> (shtraperën), <i>Brasica napus</i> (kolzen e vetëmbirë), <i>Galeopsis tetrahit</i> (galeopsin katërhojesh), <i>Tripleurospermum inodorum</i> (kamomilin e rreme), <i>Galium aparine</i> (ngjitësi).

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

135g, 270g, 320g, 430g, 540g, 1080g, 2700g.

6. VËREJTJE:

Mos ndotni ujërat me produktin e mbrojtjes së bimëve ose ambalazhin e tij. Mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes kullmëve nga fermat dhe rrugët. Shmangni çdo derdhje në mjedis, përveç qëllimit të përdorimit. Për të mbrojtur organizmat ujorë, është e nevojshme të krijoni një zonë tampon të mbuluar me bari me një gjerësi prej 5 m nga rezervuarët e ujit dhe rrjedhat e ujit. Për të mbrojtur bimët dhe artropodët jo-shënjestër, respektoni një zonë tampon të pa spërkatur: 40 m nga tokat jo-bujqësore, ose 20 m nga tokat jo-bujqësore me përdorimin e njëkohshëm të masave që reduktojnë shpërndarjen e tretësirës për spërkatje gjatë trajtimit me 50%, ose 10 m nga tokat jo-bujqësore me përdorimin e njëkohshëm të masave që reduktojnë shpërndarjen e tretësirës për spërkatje gjatë trajtimit me 75%, ose 5 m nga tokat jo-bujqësore me përdorimin e njëkohshëm të masave që reduktojnë shpërndarjen e tretësirës për spërkatje gjatë trajtimit me 90%.

7. KARENCA:

Nuk ka.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*